



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më datë 21.11.2019. ora 15.00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nën për nen i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” për:

Agjencinë Kombëtare për Diasporën

Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës

Qendrën e Botimeve për Diasporën

Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Ligoraq Karamelo, Rudina Hajdari, Ediola Braha dhe Bashkim Fino.

Mungojnë:

Elona Hoxha, Evis Kushi, Ditmir Bushati, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Adnor Shamenti, Ervin Bushati, Vasilika Hysi, Ervin Bushati, Zef Shtjefni, Halil Valteri, Reme Lala, Fatmir Velaj dhe Alket Hyseni.

Të ftuar:

Pandeli Majko - Ministër Shteti për Diasporën

Elona Bano - Drejtore Kabineti në Ministrinë e Diasporës

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirdita të gjithëve!

Faleminderit për praninë tuaj në këtë orë jo të zakonit, në mbledhjen e radhës së Komisionit për Politikën e Jashtme, i datës 21 nëntor 2019.

Në rendin e ditës kemi shqyrtimin nën për nën të projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2020”.

Janë katër qendra, për të cilat në diskutimin tonë do të detajojmë shpenzimet: Agjencia Kombëtare për Diasporën, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Qendra e Botimeve për Diasporën, si dhe Qendra e Studimeve e Publikimeve për Arbëreshët.

Të ftuar kemi zotin Majko, Ministër Shteti për Diasporën.

Ju falënderojmë, zoti Ministër, që jeni prezent edhe sot në diskutimin nën për nën.

Po ashtu, kemi të ftuar edhe zonjën Bano, drejtore e kabinetit të Ministrisë.

Mirë se vjen zonja Bano!

Zoti Ministër, fjala është për ju, në lidhje me ndonjë detajim apo sqarim, për të cilin ju mendoni se ne duhet të kemi dijeni.

Më pas, fjalën do ta ketë zonja Gjermani, si relatore.

Fjala për ju, zoti Majko.

Pandeli Majko – Në vazhdim të asaj që kemi diskutuar herën e fundit në Komisionin e Politikës së Jashtme të parlamentit, propozimet janë që, për Agjencinë Kombëtare të Diasporës, dhe për Qendrën e Botimeve për Diasporën, shpenzimet dhe buxheti të jenë në të njëjtin nivel me vitin e kaluar.

Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës fondet të jenë të koordinuara edhe me Ministrinë e Financave, sipas ecures së tre projekteve të miratuara me fondet e buxhetit të shtetit.

E vetmja kërkesa e jona ka të bëjë me Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, qendër e cila fillon funksionimin e saj në datën 1 janar. Numri limit i punonjësve është miratuar edhe në projektbuxhetin e ardhur nga Ministria e Financave, por aty kërkojmë një detajim: është një shtesë prej 17, 325 milionë lekësh, me qëllim që buxheti i Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët të shkojë te shuma limit 30 milionë lekë të reja. Është një qendër e mirëpritur nga komuniteti arbëresh.

Sa u përket dy agjencive, që praktikisht do të kenë të njëjtin nivel buxhetor, Agjencia Kombëtare për Diasporën, dhe Qendra e Botimeve për Diasporën, janë dy agjenci, të cilat kanë filluar të funksionojnë me efikasitet, jam i gatshëm të paraqes çdo shpjegim për kolegët deputetë, për pyetje të natyrave të ndryshme, sa i takon mënyrës se si është shpenzuar ky buxhet.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Ministër!

Fjala për ministren Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Majko, zoti Ministër, edhe për prezantimin në parim, edhe tani që do ta diskutojmë nen për nen.

Në fakt, një pjesë e mirë e shpenzimeve që ka kjo ministri janë pak a shumë të njëjta me ato të vitit të kaluar, që mbështesin mirëfunksionimin e këtij institucioni me të gjitha hallkat e tij. Patjetër që dua t’ju përgëzoj edhe për punën e bërë, edhe për impaktin që ka pasur ministria me punën me diasporën, me Samitin e Diasporës, për të gjitha aktivitetet që keni organizuar gjatë vitit të kaluar. Ju uroj suksese për këtë vit, për 2020-ën!

Kam 2-3 probleme, duke ndarë të njëjtin shqetësim që ju sapo thatë, për sa i përket Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, është diçka që duhet përgëzuar, është një iniciativë shumë pozitive. Ju uroj suksese!

Nga sa kam parë në tabelën e buxhetit, mendoj që ka nevojë për mbështetje, meqenëse është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në shtator të vitit 2019, në mos gabo, që të mund të funksionojë normalisht gjatë vitit të ardhshëm dhe të krijohet një urë lidhëse me arbëreshët në Itali. Ka nevojë për mbështetje financiare, ashtu siç e relatuat edhe ju.

Kam vënë re te shpenzimet e buxhetit për këtë ministri, janë të gjitha shpenzime të parashikuara për të gjitha institucionet që ju keni në varësi. Te shërbimet për diasporën sugjeroj që të detajohen, sepse shërbime për diasporën ka edhe Ministria për Punët e Jashtme dhe Europën. Duke menduar që ju e keni fokusin të drejtpërdrejtë dhe institucionet që keni si: Agjencia për Diasporën, Qendra e Botimeve për Diasporën të kenë zëra të veçantë specifike për të matur edhe efektin, në fakt siç ka funksionuar vitin e kaluar që zërat i kishit të mirëpërcaktuar.

Kam disa pyetje: desha të pyes për samitin e Diasporës për vitin 2020, si e keni menduar? Me thënë të drejtën do t’ju kërkoja publikisht, institucionalisht që Komisioni e Jashtëm, Nënkomisioni i Diasporës, të gjithë kolegët këtu duhet të jenë më të përfshirë në të

gjithë procesin e përgatitjes dhe realizimit të këtij samiti, sepse mendoj që kapacitetet, potencialet mund të jenë edhe ndihmë për ministrinë, por dhe vetë deputetët do të ndihen shumë aktivë dhe të përfshirë.

Pyetja tjetër ka të bëjë me votimin e emigrantëve, si është parashikuar, si e mendoni punën që keni nisur, si do ta vijoni në vitin 2020? Konkretisht a e keni të mbuluar në buxhet këtë gjë?

Pyetja e tretë, ka të bëjë me fondet dhe investimet e huaja: çfarë mbështetje keni nga donatorët, ku dhe si do t'ju mbështesin për ta plotësuar spektrin e aktiviteteve tuaja? Ndoshta jo me detaje, por në mënyrë të përmbledhur.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit, ish-Ministrja Gjermani!

Dua vetëm t'ju rikujtoj që ministrat duhej të kishin mbaruar relatimin, pastaj unë të kërkoja të hapej pjesa për pyetje dhe diskutime.

(Diskutime pa mikrofon)

A ka pyetje të tjera?

Eljo Hysko – Për sa i përket samitit të diasporës, doja të shtoja diçka në lidhje me atë që tha zonja Gjermani. Sa prej zotimeve që janë marrë nga samiti, janë realizuar ose janë adresuar? Në çfarë faze janë? Cilat do të jenë të rejat që janë parashikuar për samitin e këtij viti?

Për sa i përket Qendrës së Botimit të Diasporës, a keni parashikuar mënyra alternative të botimit, të cilat janë më pak të kushtueshme se sa botimet (pra, të jenë në mënyrë dixhitale) dhe a i keni drejtuar këto botime drejt fëmijëve, të cilët rriten në diasporë? Këtu nuk po flas vetëm për kurrikula mësimore, por po flas për botimet në gjuhën shqipe në tërësi. Në qoftë se po, në çfarë faze janë ato?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Hysko!

Meqë nuk ka pyetje nga kolegët, e ndiej për detyrë të bëj pyetjen e radhës.

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët e krijuar me VKM në shtator të këtij viti, e kemi diskutuar edhe në parim, që ju parashikoni një numër punonjësish të qendrës, pavarësisht se nuk është parashikuar buxheti për këtë institucion, unë do të pyesja nëse do të akordohet një vlerë shtesë për qendrën gjatë vitit? Nëse po, kur?

Për Agjencinë Kombëtare të Diasporës keni parashikuar 3 milionë lekë investime kapitale. Për çfarë lloj investimesh flitet?

Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka buxhet, apo keni kërkuar buxhet? Funksionon me projekte? Pse keni kërkuar buxhet?

(Diskutime pa mikrofon)

Dakord.

Ju keni folur për Dhomën e Biznesit të Diasporës. A jam e saktë, zoti Ministër? Gjithashtu, ju kërkonin një fond prej 3 milionë lekësh të miratuar si shpenzim kapital. Për çfarë flitet në këtë rast? Është qira, rikonstruksion, apo blerje godine? Nëse po, ku?

Qendra e Botimeve të Diasporës.

Botimet.

Keni kërkuar shpenzime kapitale 16 milionë lekë. Për çfarë i kërkonin këto shpenzime kapitale? Ndërkohë në detajimin që u bëni shpenzimeve për Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, përveç pagave që i keni llogaritur bazuar në 12 punonjës që kërkonin, kërkonin rishtas 3 milionë e 500 mijë lekë kapitale. Për çfarë flitet?

Faleminderit!

Po, zonja Hajdari.

Rudina Hajdari - Faleminderit, zonja kryetare!

Unë kam një pyetje në lidhje me regjistrimin e personave jashtë vendit. A e keni një gjë të tillë, sepse po lexoja draftin e dytë, që ka ardhur në Komisionin e Reformës Zgjedhore dhe aty parashikohet që një nga kompetencat e KQZ-së së re të jetë pikërisht kjo. A ka një përplasje këtu me organin tuaj? Pra, a do t'ju marrë juve kompetencën? Qeveria vetë nuk do të ketë regjistrim të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit. Doja vetëm një sqarim në lidhje me këtë, sepse do të më ndihmonit.

Mimi Kodheli – Ministër, fjala për ju.

Pandeli Majko – Për sa i përket Samitit të diasporës për buxhetin e vitit 2020 nuk parashikohet ndonjë fond, sepse edhe me kërkesën e përfaqësuesve të ndryshëm të diasporës, është menduar të zhvillohet një herë në dy vjet. Për më tepër, në datën 18 dhjetor, në bazë të legjislacionit të miratuar nga parlamenti, u krijua Këshilli i Koordinimit të Diasporës, janë 15 përfaqësues nga BE-ja, SHBA-të, Kanadaja, Australia dhe Turqia dhe do të jetë ky këshill që do të merret me menaxhimin, pra trajtimin dhe organizimin e buxhetimit të Samitit do të kalojë në

duart e këtij Këshilli. Ndërkaq ne po punojmë që ky samit të mos jetë thjesht për buxhetin e qeverisë shqiptare, por të ketë edhe bashkëfinancim me qeverinë e Kosovës, pasi të dyja qeveritë janë orientuar të trajtojnë një diasporë, jo të vendosim kufijtë shtetërore edhe në ndarjen e diasporës shqiptare, për më tepër që bëhet fjalë edhe për diasporë nga shqiptarët e Maqedonisë, Malit të Zi dhe Preshevës.

Për sa i përket çështjes së votimit të emigrantëve, që e ngriti zonja Gjermani, por edhe pyetjen që bëri zonja Hajdari, u diskutua gjerësisht edhe në mbledhjen e fundit. Ne kemi ngritur edhe një grup teknikësh që e drejtojnë unë, i cili brenda muajit dhjetor duhet të paraqesë propozimet lidhur me detajet teknike, por, në çdo rast, vendimmarrja do të jetë e komisionit rreth reformës zgjedhore këtu në parlament. Ne nuk mund të bëjmë gjë tjetër veçse të propozojmë detajet teknike, si lehtësues të procesit të diskutimit në Komisionin e Reformës Zgjedhore.

Sa i përket diskutimit të shtetasve jashtë vendit, është një ligj i veçantë, i miratuar në parlament për regjistrimin e adresave. Ndërkaq nga kompania që bën kartat e identitetit dhe pasaportat shqiptare, për efekt të plotësimit të afatit 10-vjeçar, janë duke u ribërë pasaportat, në bazë të legjislacionit në fuqi, të të gjithë shtetasve shqiptarë. Ky është një rast i mirë të kemi një integrim të informacionit të ligjit për adresarin më të cilin po merren Ministria e Brendshme dhe Ministria e Jashtme. Ky zëvendësim i pasaportave dhe kartave të identitetit për efekt të plotësimit të afatit 10-vjeçar bëhet nga kompania ndërkombëtare Aleat.

Unë mendoj se ky nuk është një proces i politizuar, nuk ka të bëjë me fushën e përgjegjësisë së diasporës, për më tepër, siç ju thashë edhe herën e kaluar, kur është diskutuar ligji i Agjencisë Kombëtare të Diasporës, megjithëse ne kishim thënë që suporton çështjen e regjistrimit të shtetasve, me insistimin e përfaqësuesit të opozitës kjo është hequr dhe ne jemi thjesht asistues, ose e ndjekim situatën në distancë, por në asnjë rast nuk jemi ne që ta bëjmë këtë çështje. Në bazë të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor dhe në bazë të eksperiencave që ekzistojnë si modele të gatshme funksionale në shtetet e tjera, kjo është një çështje që do të mbulohet në mënyrë të plotë nga KQZ-ja. Ai është vendimmarrësi dhe gjykata, nëse mund të flasim kështu, e zgjedhjeve që do të përcaktojnë udhëzime dhe rregullore dhe mënyra si do të jetë në parim. Për këtë është rënë dakord edhe me teknikët që po diskutojmë, padashur të nxjerr ndonjë sekret, i duhen lënë sa më shumë kompetenca KQZ-së, sepse është detajim teknik i rëndësishëm, por që duhet të jetë me transparencën përkatëse pa kaluar në duart e ekzekutivit.

A të vazhdoj të përgjigjem për pyetjet e tjera?

Sa i përket buxhetit nga donatorët, po e lidh, nëse më lejon kryetarja, me pyetjen që u bë për Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Fondi është protagonisti kryesor që po punon me donatorët. Ne jemi duke hartuar një program të veçantë sa i përket të gjitha projekteve bazuar në 72 masat e planit të veprimit të strategjisë kombëtare të diasporës, miratuar me vendim të posaçëm të qeverisë dhe nga fillimi i vitit, që vjen brenda 3 mujorit të parë, të kemi tavolinën e parë me donatorët, pasi duam të jemi të qartë ku jemi dhe ku duam të shkojmë, gjë të cilën donatorët e kanë të rëndësishme.

Për më tepër, jo vetëm në bazë të ligjit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, por edhe të ligjit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, të gjitha agjencitë e diasporës janë të detyruara të sjellin raporte të detajuara në çdo fundviti në Komisionin për Diasporën dhe Migracionin, por pa diskutim edhe për Komisionin e Jashtëm, si janë shpenzuar paratë, ku janë çuar paratë, jo vetëm të buxhetit, por edhe të donatorëve të huaj.

Aktualisht kemi një projekt që po ecën mjaft mirë me zyrën e IOM-it në Shqipëri, e cila është implementuesja e programit të Koperacionit Italian, i cili është dhënësi i buxhetit për këtë program. Jemi duke bashkëpunuar me qeverinë e Zvicrës, po ashtu edhe me GIZ-in e Gjermanisë. Mendojmë që situata do të jetë në zhvillim, pasi, siç e dini, donatorët janë në një moment konservativ dhe jo shumë liberal sa i takon dhënies së fondeve, por mirëbesimi ka filluar që tani për këtë çështje.

Sa u takon botimeve për fëmijët dhe se në çfarë faze jemi, dua t'ju them që është një moment, i cili i takon fushës së përgjegjësisë së Qendrës së Botimit për Diasporën, e cila drejtohet nga një këshill i specializuar me përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Akademia e Shkencave dhe specialistë të fushës. Ka filluar implementimi i programit të parë të botimeve për fëmijët, por jemi duke insistuar, sidomos për botimet dygjuhësore, sepse një pjesë e fëmijëve janë brezi i dytë që kanë lindur në shtetet pritëse të shtetasve tanë dhe besoj se ky do të jetë një program i suksesshëm, pasi bazohet në modele që kanë funksionuar edhe për diasporat e vendeve të tjera.

Dua t'ju them që falë punës së mirë që ka bërë Qendra e Botimeve të Diasporës, sot që jemi duke folur, jemi duke furnizuar ndonjë shkollë, por për arsye të mungesës së besimit që ka pasur paraprakisht, nuk kanë depozituar kërkesë pranë ambasadave tona për furnizimin me libra, sepse ka qenë viti i parë ku të gjithë mësuesit dhe shkollat kanë marrë librat dhe gjithë strukturën e botimeve para fillimit të vitit të ri shkollor. Shumë shpejt, gjatë muajit dhjetor, do të kemi

takime me grupmësuesit e Italisë dhe të Greqisë për t'ju dhënë atyre, edhe me vendimin e fundit të qeverisë, programet shtesë plotësuese që janë përgjithësisht letërsi për fëmijët. Ndoshta jam duke folur shumë për këto detaje, sidomos për letërsinë e fëmijëve, por mendoj se është gjëja më e mirë që jemi duke bërë aktualisht. Për herë të parë me programe të Agjencinë Kombëtare të Diasporës kemi dërguar mësues, të cilët kanë mësim për periudha të shkurtra 2-javore në Kroaci dhe Ukrainë dhe jemi duke u përgatitur për zonat e arbëreshëve në Itali dhe në Sicili.

Është një program në të cilin duam të ftojmë edhe donatorët, por përgjithësisht në fazën e parë jemi duke ecur duke u bazuar në fondet e buxhetit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Sa u takon premtimeve ato janë realizuar. Nuk besoj se kemi ecur me logjikën e premtimeve, por me logjikën e strategjisë dhe të masave të planit të veprimit për të cilat japim llogari të paktën 1 herë në 3 muaj publikisht, duke ju sjellë një buletin të veçantë lidhur me ecurinë e këtyre masave. Ky buletin nuk është vetëm për Komisionin e Politikës së Jashtme, por ai publikohet.

Sa u takon pyetjeve që bëri kryetarja e komisionit për AKD-në, dua t'ju them se 3 milionë fonde investime kapitale janë pajisje për Agjencinë Kombëtare të Diasporës, ndërsa sa i takon Qendrës së Botimeve është në proces pajisja me skaner, të cilën mund të mos e blejmë dot këtë vit, për arsye se është pezulluar blerja e makinave për të gjitha institucionet, e cila kapi edhe furgonin që do të transportonte libra.

Për Qendrën e Arbëreshëve 3 milionë fondet kapitale janë pajisjet dhe qiraja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e kemi, sepse ende presim buxhetimin, të marrim vulën dhe të hapim llogarinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Parashikimin e kemi bërë, të njëjtën gjë po ndjekim me Dhomën e Biznesit, fondet e projektit janë pajisjet dhe qiraja. Në datën 27 nëntor bëhet inaugurimi i Dhomës së Biznesit. Janë gjetur ambiente shumë të mira, besoj siç i takon gjithë shtesës së biznesit që do të bëhet pjesë e kësaj dhome. Mendojmë se jemi duke bërë një projekt të suksesshëm dhe javën që vjen, do të bëjmë inaugurimin e kësaj dhome.

Mimi Kodheli – Faleminderit, Ministër!

Para se të fillojmë me komentet, t'ua lë fjalën zonjës Hajdari dhe zotit Gjoni, kisha edhe një pyetje të fundit: në materialin paraprak që më është përcjellë nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, flitet me të drejtë edhe për Diasporën, shpenzimet që i takojnë (besoj nuk është

drejtori, është sektor) për këtë do të pyes ministrin që do të jetë nesër prezent, por nga ju dua të di nëse Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme është konsultuar me ju, për aq kohë sa ministria mendon që paratë në buxhet që i takojnë këtij aktiviteti, kanë të bëjnë me krijimin e Regjistrimit të Diasporës së Kualifikuar dhe zbatimin e programeve kombëtare të përbashkëta me institucionet ndërkombëtare, me qëllim tërheqjen e anëtarëve të kualifikuar të Diasporës për t'i shërbyer ekonomisë së Shqipërisë. E para.

Hartimi i strategjisë së diplomacisë dixhitale që do të kontribuojë në strukturimin më të mirë të punës në Shqipëri për t'u njohur ndërkombëtarisht me një imazh të përmirësuar pozitiv, promovimin e imazhit të Shqipërisë dhe shqiptarëve që jetojnë në Diasporë nëpërmjet Colors of Albania dhe promovimin në shkallë të gjerë të regjistrimit të emigrantëve dhe informimit për të drejtën e votës. Jeni konsultuar me Ministrinë e Europës dhe Punëve të Jashtme për këtë gjë?

Faleminderit!

Pandeli Majko – Jo, nuk na takon neve të konsultohemi. Nëse bëhet fjalë që dikush vendos një fond në buxhetin e vetë për Diasporën, mendoj që duhet të na pyeste, dhe po të na pyeste, do t'i thoshim se për këtë çështje Fondi i Zhvillimit ka 2 projekte “Diaspora për Zhvillim” dhe projekti “Diaspora Shkencore”. Nuk po them se nuk duhet të ketë shpenzime për Diasporën në Ministrinë e Jashtme, por mbase mendoj se duhet bërë një lloj kolaudimi në këtë drejtim. Përveç të tjerash, në bazë të akteve që funksionojnë ka një ndarje, e cila funksionon si e tillë. Për shembull, librat e arsimit i paguan Qendra e Botimeve për Diasporën, por transporti i librave bëhet me fondet e Ministrisë së Jashtme. Megjithatë, për mua kjo është e rëndësishme ta nënvizoj, pavarësisht se nuk kemi pasur konsultim, këto fonde mund të bëhen komplementare pas një konsulte në një fazë të dytë pas miratimit të buxhetit. Nuk e shikoj si një problem të jashtëzakonshëm.

Mimi Kodheli – Së pari, unë nuk e shikoj si problem, sepse prandaj ju pyeta, por ajo çka unë shikoj si problem të zgjidhshëm është që shumëçka nga fondet që i takojnë Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, të cilat janë të lidhura me diasporën, të mund t'i kalojnë ministrisë suaj. Kështu, do të kemi një kompensim më të drejtë, ndaj po mundohemi të gjejmë disa fonde për ministrinë tuaj.

Pandeli Majko – Zonja Kryetare, ministri i dekretuar për Europën dhe Punët e Jashtme është edhe Kryeministër, kështu që në qoftë se doni të më fusni në debate me Kryeministrin, dakord. Besoj se e kuptuat pjesën e humorit. Unë jam i gatshëm për çfarëdolloj dialogu me

kolegët e mi në qeveri, sidomos për të marrë pjesën e pambuluar të fondit për Qendrën e Arbëreshëve dhe jam i bindur që do të kem edhe mirëkuptimin e tyre.

Mimi Kodheli – Këtë gjë duhej ta kishit bërë, zoti Ministër!

Pandeli Majko – Ju lutem, çdo ministri ka arsyet tij. Pra, qoftë Ministria e Kulturës, qoftë Ministria e Arsimit, qoftë Ministria e Shëndetësisë apo edhe Ministria e Bujqësisë kanë mënyrat e tyre të trajtimit të fenomeneve të diasporës, përfshi këtu edhe Ministrinë e Jashtme. Ne e kemi thënë edhe kur e kemi diskutuar buxhetin në parim që gabimi i përsëritur i Ministrisë së Financave ishte që, kur e ka sjellë buxhetin, e ka sjellë njëlloj si vitin e kaluar, duke vënë zërin në shërbime për diasporën, pas diskutimit në komisionin tuaj të nderuar, u ra dakord që të gjitha agjencisë ta kishin buxhetin të ndarë sipas zërave përkatës. Kështu që mendoj se vendosja e zërave për diasporën nga ministrinë e tjera nuk ka asnjë problem. Siç ju thashë, nuk ka pasur konsultime dhe nuk jam unë ai që duhet t'u kërkoj konsulta ministrive të tjera, por duhet të jenë ministrinë, të cilat vendosin fonde për diasporën për të thënë se sa komplementare janë këto me strategjinë e diasporës. Besoj se deri këtu, duke qenë se me një pjesë të kolegëve ndajmë eksperiencën nga ekzekutivi, duhet të më mirëkuptojnë në këtë që po them.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Ministër!

Po, zonja Hajdari, komenti juaj.

Rudina Hajdari - Kam një koment të shkurtër dhe një pyetje, nëse më lejohet, në vijim të asaj që ju thatë pak më parë në lidhje me propozimin që mund t'i bëni Komisionit të Reformës Zgjedhore. Ju thatë se mund të bëni një propozim konkret, ndoshta jam e gabuar, që Komisioni i Reformës Zgjedhore do të ketë kompetencën për të bërë regjistrimin. Po ashtu, ju thatë se ministria juaj mund të bëjë një propozim në lidhje me mënyrën apo me mekanizmin që mund të ndjekin, sepse ideja është që në momentin që miratohet drafti i dytë ne duhet të kemi një ide konkrete se si mund të ndodhë kjo gjë. Pra, unë dua të di: a do të kemi një propozim nga ana juaj lidhur me këtë pikë?

Komenti im, në fakt, ka të bëjë me një kompliment për ju, sepse vërtet mendoj se keni bërë një punë jashtëzakonisht shumë të mirë. E mbaj mend herën e parë që keni ardhur këtu me një portofol shumë të vogël dhe sot e keni zhvilluar këtë portofol me iniciativë shumë të bukura, ndaj dua thjesht t'ju komplementoj për punën që keni bërë deri më sot.

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegë!

Po, zoti Gjoni, mund të bëni komenti juaj.

Ralf Gjoni – Në fakt, ma mori zonja Hajdari komplimentin. Ndoshta është hera e parë, që kur kam marrë mandatin e deputetit, që e ndjej veten të pafuqishëm për të bërë opozitë, përballë një peshe të rëndë si ish-Kryeministri Majko, të cilin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të nderuar kolegë, unë me sinjeritet besoj se është nder për Shqipërinë dhe për çdo qeveri që do të ishte në pushtet, që të kishte një ish-Kryeministër, si zoti Majko, në krye të Ministrisë së Diasporës, pavarësisht se është ministri pa portofol.

Më ngelet vetëm që t'ju inkurajoj të vazhdoni më tej dhe t'i kushtoni më shumë vëmendje Samitit të pritshëm për Diasporën. Gjithashtu, bashkohem me relatoren, zonjën Gjermani, që çdo lloj ndihme që do t'ju duhet, jo vetëm nga ne si anëtarë të Komisionit të Jashtëm, por edhe nga deputetët e tjerë të grupeve parlamentare të opozitës, unë ju siguroj se do të keni mbështetjen dhe predispozitën tonë maksimale në funksion të arritjes së objektivave kombëtare lidhur me diasporën.

Një koment tjetër: e përshëndes nismën lidhur me Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, ku janë parashikuar 12 punonjës. Unë ju sugjeroj që sapo të krijohet të merrni me qira një autobus dhe 12 punonjësit t'i çoni, unë jam i gatshëm të vij me ju, në një tur në fshatrat arbëreshe, sepse mendoj se nuk ka diasporë më simpatike dhe më të respektueshme sesa komuniteti arbëresh, të cilët kanë 5 shekuj që ruajnë traditën, kulturën dhe gjuhën, ndryshe nga anëtarët e tjerë të diasporës shqiptare, që nuk kanë më shumë se 100 vjet jashtë Shqipërisë, dhe na përfaqësojnë me një krenari të paparë, e cila nuk ndahet nga anëtarët e tjerë të diasporës shqiptare në botë.

Gjithashtu, të bashkohemi edhe me kryetaren Kodheli, sepse ministri Majko ndoshta e ka të pamundur të futet në sherr me Kryeministrin dhe njëkohësisht ministër i Jashtëm, zotin Rama. Pra, do të ishte në nderin e këtij komisioni që t'i drejtohem përmes një shkrese ku të sugjerojmë miqësisht, por edhe institucionalisht transferimin e fondeve të parashikuara për Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, drejt ministrit të Shtetit për Diasporën, sepse mendoj se ky buxhet duhet të jetë në dispozicion për këtë ministri, për t'i dhënë kapacitetet maksimale për ta kryer detyrën e tij fisnike.

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Gjoni!

Në fakt, nuk është e nevojshme që këtë kërkesë t'ia bëjmë Kryeministrit, njëkohësisht edhe ministër i Punëve të Jashtme, sepse ne mund ta gjenerojmë këtë kërkesë pranë Komisionit

të Ekonomisë që ta miratojë në parlament, pa qenë nevoja që kalimet e parave nga një program në një tjetër të rikërkohen në qeveri.

Fjalën e ka zoti Bushati.

Ditmir Bushati – Faleminderit, zonja kryetare!

E para, dua t'i bashkëngjitëm apelit që bënë kolegët e tjerë. Duket qartë që ka një gabim teknik dhe për këtë arsye Ministria e Financave ka përlogaritur stafin, por nuk ka përlogaritur aktivitetet, sepse nuk bëhet fjalë për ndonjë buxhet marramendës. Pra, është në nderin e këtij komisioni që në relacionin përfundimtar t'i japim një mbështetje për kërkesën që vjen nga ministri i Shtetit për Diasporën. Ne kemi pasur edhe raste të tjera që buxheti është përmirësuar falë sugjerimeve që kanë ardhur nga deputetë dhe grupe parlamentare në të gjitha fazat e shqyrtimit të tij në Kuvend, deri në seancën plenare.

Së dyti, nuk e di se cilit dokument ju referuat, por është mirë që të mos ngatërrojmë fushën e veprimit të institucioneve të ndryshme të shtetit shqiptar, meqenëse këtu u bë edhe një propozim tjetër. Ministria e Jashtme ka një rol tjetër të drejtpërdrejtë për sa u përket shqiptarëve që jetojnë jashtë atdheut dhe kjo është arsyeja pse figuron qoftë si pjesë e diplomacisë publike dhe punës së përditshme që bëhet me diasporën, me aspektet pozitive dhe me mangësitë sistemike që ne kemi. Këtu u tha edhe nga ministri Majko, për shembull, që kur vjen puna të shpërndarja e teksteve shkollor, ka një zë të posaçëm ministri Majko, ka një zë tjetër Ministria e Punëve të Jashtme dhe ka një mbrojtje konsullore. Është detyrë e shtetit shqiptar që t'ua ofrojë shtetasve që jetojnë jashtë atdheut. Sikundër ka edhe disa procese që koordinohen nga ministri i Shtetit për Diasporën, por njerëzit në terren, të cilët janë pjesë e shërbimit të jashtëm, duhet të paguhet nga ai buxhet. Prandaj buxheti që ka Ministria e Jashtme për këtë fushë veprimi është shumë simbolik i tillë është edhe këtë vit nga leximi që kam bërë, pra nuk ka asnjë lloj ndryshimi, por nuk është se ka një përplasje me fushën e veprimit apo me punën që bëhet nga ministri për Diasporën.

Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, kjo është më tepër në trajtën e një pyetjeje, ne para disa kohësh, ashtu siç ju referuat, kemi kaluar ligjin “Për regjistrimin e adresave” dhe kemi pasur disa detyrime konkrete, qoftë strukturat e shtetit, si Ministria e Jashtme dhe e Ministria e Brendshme. Viti 2019 pritet që të ishte një vit jashtëzakonisht hiperaktiv për shkakun që ju e vutë në dukje, sepse skadonte 10-vjeçari qoftë i pasaportave apo i kartave të identitetit. Kam një pyetje të thjeshtë, duke qenë se jam i bindur që në çdo aktivitet që shkoni me diasporën,

kjo është pyetja e parë që bëhet (të paktën këtë e kam ndjerë gjatë ushtrimit të detyrës së ministrit të Jashtëm): kur do të realizohet e drejta jonë për të marrë pjesë në procesin zgjedhor? A keni një informacion që mund ta ndani me ne, pra ku jemi ne në këtë proces? Pra, në qoftë se e kemi bërë atë hartëzimin e plotë të diasporës dhe, në qoftë se e kemi identifikuar qoftë përmes zbatimit të ligjit apo edhe të bashkëpunimit me ato shtete, ku kemi një përfaqësi të madhe shqiptare? A jeni optimist, realist apo pesimist që zgjedhjet e ardhshme parlamentare në Shqipëri do t'u japin mundësinë edhe shqiptarëve që jetojnë jashtë atdheut për të marrë pjesë në këtë proces?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Fjala për ju, zoti Ministër.

Pandeli Majko – Faleminderit!

Për sa i përket problematikës së votimit, jam shumë optimist që në zgjedhjet e vitit 2021 ne i kemi të gjitha mundësitë administrative për të realizuar të drejtën e votës për shtetasit tanë jashtë vendit. Ashtu siç tha edhe kolegu, mendoj se Ministria e Brendshme dhe Ministria e Jashtme kanë marrë me përgjegjësi ligjore çështjen e adresarit. Ndërkaq edhe kompania, që po bën zëvendësimin e pasaportave dhe kartave të identitetit, është një mundësi shumë e mirë që ne ta kemi të mbikontrolluar këtë proces të regjistrimit të shtetasve tanë jashtë vendit. Për këtë arsye ne jemi duke punuar fort për sa u përket detajeve teknike të modelit, pa ndryshim të Kushtetutës fillimisht dhe pastaj ta gjykojë Komisioni i Reformës Zgjedhore se çfarë do të bëjë në vazhdim. Ne me ekipin teknik kemi ngritur të gjitha institucionet kryesore përgjegjëse për të drejtën e votës së shtetasve tanë jashtë vendit. Jemi duke mbyllur momentin e parë të hedhjes së draftit për ndryshimet në Kodin Zgjedhor, por dua ta përsëris se të gjitha propozimet tona teknike do të jenë përballë vendimmarrëse të vërtetë, që janë anëtarët e Komisionit të Reformës Zgjedhore në Kuvendin e Shqipërisë. Ata do ta ndajnë se ku do të jetë balanca, po kthehem te pyetja e zonjës Hajdari, se kush do të jetë përgjegjës për çfarë dhe si do ta kryejë atë; çfarë do të ketë KQZ-ja, ku dhe si do të mbarojnë përgjegjësitë e institucioneve të ekzekutivit për regjistrimin e shtetasve dhe si do të menaxhohen listat e votuesve.

Pa diskutim që do të kemi një mënyrë të re të të parit të gjërave, sepse ne në Kushtetutë nuk kemi asnjë pengesë për votimin e shtetasve jashtë vendit. Që në vitin 1998 e drejta për të votuar jashtë vendit ka qenë e garantuar, sepse Kushtetua kërkon vetëm moshën dhe shtetësinë

për të drejtën e votës, Kodi Zgjedhor ka shtuar edhe vendbanimin. Kështu që ne me ndryshimet e Kodit Zgjedhor do ta shtojmë këtë të drejtë që, pavarësisht vendbanimit, të jetë e drejta e votës, por këtu do të kemi edhe disa definicione të reja, të cilat duhen përcaktuar. Për shembull, nëse për listat e votuesve deri më sot kemi pasur një listë, tani do të kemi dy lista: atë të shtetasve jashtë vendit dhe atë të atyre brenda vendit. Për shtetasit brenda vendit do të jenë të njëjta me të votuesve brenda vendit, ndërsa për shtetasit jashtë vendit duhet të ketë diskutim në Komisionin e Reformës Zgjedhore, siç e kemi ne në nivelin teknik. Për shembull, do t'u çojmë zarf të gjithë njerëzve, të cilët janë jashtë vendit, apo do të ketë një shprehje të vullnetit?! Pastaj mbi bazën e shprehjes së vullnetit, nga listat e shtetasve që jetojnë jashtë vendit, ne do të krijojmë listën e votuesve në zgjedhjet e vitit 2021, gjithmonë duke bazuar në modele funksionuese, sepse nuk duam të bëjmë asnjë lloj eksperimenti.

Sigurisht që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të shkëputet nga rutina e zgjedhjeve të deritanishme, puna e tij do të ndahet në dy lloje administrime të zgjedhjeve: njëra për shtetasit që jetojnë brenda vendit dhe tjetra për shtetasit që jetojnë jashtë vendit. Sigurisht që për këtë duhet të dalin udhëzime dhe rregulla, në të cilat, nëse do të më pyesni mua, i duhet dhënë më shumë kompetencë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të mos e kthejmë Kodin Zgjedhor në një rregullore për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për këtë çështje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, Ministër!

Atëherë, unë jam dakord me ato që zoti Bushati tha në lidhje me disa gjëra, që ne mund t'i përcjellim pranë Komisionit të Ekonomisë, që kanë të bëjnë me rritjen e buxhetit të Ministrisë për Diasporën. Ndaj e respektoj edhe vlerësimin që i bëni ministrit lidhur me punën e bërë gjatë vitit të kaluar, edhe me atë limitim buxhetor që ka pasur. Kështu që nuk na mbetet gjë tjetër veçse ta miratojmë këtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, ne jemi partikularë në këtë komision, nuk jemi si komisionet e tjera.

Zoti Sterjovski, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, por fjalën kërkojeni, përpara se të kalojmë në votim.

Fjalën e ka zoti Sterjovski, për të kaluar më pas direkt në votim.

Vasil Sterjovski – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, unë kam një koment të shkurtër.

Në datën 14 nëntor patëm mbledhjen e komisionit, ku diskutuam projektbuxhetin e Ministrisë së Diasporës. Unë i bëra një pyetje zotit Majko nëse në Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës kanë të drejtë të aplikojnë edhe pjesëtarët e diasporës shqiptare me përkatësi të ndryshme nga shqiptarët, siç janë ata të minoriteteve. Ministri në përgjigjen e tij më tha që ky Fond është vetëm për shqiptarët dhe jo për minoritetet që janë qytetarët shqiptarë, por që janë jashtë diasporës.

Duke qenë se ju nuk ma dhatë fjalën asokohe që të bëja një koment, po shfrytëzoj rastin tani. Unë mendoj se nuk është e drejtë që Ministria e Diasporës, pavarësisht se ka bërë një punë shumë të mirë për evidentimin e diasporës dhe për bashkëpunimin e saj me vendin tonë, pra të përjashtohen nga ky bashkëpunim pjesëtarët e minoriteteve që janë qytetarë të ligjshëm që jetojnë jashtë vendit tonë, por mendoj se kjo ministri duhet të punojë edhe me minoritetet, t'i kontaktojë, sepse minoritetet e diasporës jashtë vendit tonë janë të organizuar si në rang fshati, ashtu edhe në rang zone kudo nëpër Europë. Ndaj duhet që edhe ne ta shfrytëzojmë këtë kapital, aset, sepse ata janë të mirintegruar në vendet ku punojnë. Madje edhe në Samitin e Diasporës duhet të përfshihen pjesëtarë të shquar të minoriteteve që jetojnë jashtë. Pra, nuk e shikoj të drejtë që te ky fond të mos kenë të drejtë të aplikojnë edhe shoqatat e minoriteteve që janë jashtë në Europë, sepse, në fund të fundit, ky Fond përbëhet nga taksat e të gjithë shtetasve shqiptarë, edhe të ne minoriteteve që jetojmë në këtë vend. E përsëris, nuk e shikoj të drejtë që diaspora minoritare të përjashtohet nga fondet. Mund të marr si shembull Republikën e Maqedonisë së Veriut (ku, gjithashtu, ka një ministër për Diasporën, që është shqiptar dhe ministër vërtet shumë i mirë edhe ai), e cila nuk i përjashton minoritetet. Të gjithë qytetarët maqedonas, që janë në diasporë, mbajnë lidhje me këtë ministri dhe marrin fonde direkt nga kjo ministri për zhvillimin e kulturës së tyre, pavarësisht se ku jetojnë në Europë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Sterjovski!

E hedhim projektligjin në votim. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jeni kundër, apo abstenoni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, një votë kundër dhe një abstenim.

Miratohet.

Zoti Ministër, ju falënderoj për prezencën dhe seriozitetin!

Punë të mbarë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbledhja e ardhshme do të jetë nesër në orën 12:30, ku do të kemi të pranishëm ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme.

Pandeli Majko – Ju faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Faleminderit ju!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretare
Elona Hoxha

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Ina Jano